




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.kk.rks-gov.net; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Në pajtim me nenin 11.12 pika C) dhe në zbatim të nenit 17 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 39 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-53125 të dt. 11.11.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 27.12.2011, miraton këtë:

V E N D I M

- I. Me qëllim të nxitjes së zhvillimit lokal ekonomik, bizneset prodhuese në komunën e Gjilanit lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale për 5 pesë vitet e ardhshme duke filluar prej 01.01.2012.
- II. Bizneset prodhuese dhe jo prodhuese të cilat regjistrohen gjatë vitit 2012, lirohen nga tarifat dhe ngarkesat komunale nga dita e regjistrimit të biznesit për 3 vitet e ardhshme duke filluar prej 01.01.2012.
- III. Bizneset joformale të cilat regjistrohen deri në fund të muajit mars të vitit 2012, lirohen nga tarifat dhe ngarkesat nga dita e regjistrimit të biznesit për 2 vitet e ardhshme duke filluar prej 01.01.2012.
- IV. Prodhuesve të komunës (prodhuesve bujqësor) u epet gratis në dispozicion hapësira publike për përdorim sezonal.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, kurse ekzekutimin e tij e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- VI. Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01. Nr. 16-67248
Gjilan, më 27.12.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues